



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 189, Datë 13.07.2026

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING”
SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “ç” dhe 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13, 14 pika 9 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1564/6 prot., datë 09.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 02.12.2026.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1564/1 prot., datë 26.05.2026.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 492, Seria F21, është 02.12.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 02.06.2026.
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 169, datë 15.06.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.06.2026 dhe 17.06.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.06.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1564/4 prot., datë 17.06.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1564/5 prot., datë 26.06.2026, ka depozituar informacionin /dokumentacionin e kërkuar.

- Rezulton se shoqëria ka aktualisht një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, por duke qënë se afati i saj përfundon më 01.11.2026 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën 5-vjeçare të vlefshmërisë së licencës, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë që brenda kësaj date të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar, ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet ligjore dhe rregullatore për rinovimin e licencës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me kushtin e sipërcituar lidhur me dokumentimin e disponimit të zyrave përfaqësuese.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 492, Seria F21, të shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 241, datë 02.12.2021, për një afat 5(pesë)-vjeçar, me efekt nga data 03.12.2026.
2. Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., jo më vonë se data 01.11.2026, të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së licencës.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI